



RAPORT MONITORIMI
PËR ZBATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË
GJINORE 2022-2024

Përgatitur nga Bashkia Elbasan

Korrik 2025

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
HYRJE.....	6
PËRMBLEDHJE E PROGRESIT TË ZBATIMIT	9
Fusha I: Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.	9
Fusha II: Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.....	10
Fusha III: Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qendrueshëm.	13
Fusha IV: Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.	15
BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR DHE ALOKIMET	20
SFIDAT NË ZBATIM	21
PRAKTIKAT E MIRA DHE HISTORITË E SUKSESIT	22
REKOMANDIME DHE HAPAT NË VIJIM.....	23

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ofron një përmbledhje të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2022–2024 në kuadër të angazhimeve të ndërmarra nga Bashkia Elbasan për zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.¹

Raporti u përgatit nga Bashkia Elbasan me mbështetjen dhe asistencën teknike të UN Women, në kuadër të zbatimit të projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2022 – 2024 u përgatit nga Bashkia Elbasan, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore. Bashkia Elbasan e ka nënshkruar këtë Kartë, të përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës² në 23 shkurt 2017, duke ndërmarrë kështu një angazhim publik për të hedhur hapa konkretë dhe të duhur për bërjen realitet të barazisë gjinore në Elbasan. Ky ishte plani i dytë i veprimit i hartuar³ dhe zbatuar për këtë qëllim, përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, median, bizneset, Këshillin Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtarë e antarë të Këshillit Bashkiak. Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024 i Bashkisë Elbasan, u miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 64 datë 30.05.2022.

Nga analiza e zbatimit të PVVBGJ 2022 – 2024 rezulton se Bashkia Elbasan ka demonstruar progres në të katër fushat ndërhyrëse të planifikuara në këtë PVVBGJ. Ndër arritjet kryesore përmendim:

FUSHA I: PËRPARIMI NË KUADRIN E PËRGJITHSHËM TË BARAZISË GJINORE

- Pjesëmarrja e rregullt e Nëpunësës së Barazisë Gjinore në mbi 30 takime të buxhetimit me pjesëmarrje, të zhvilluara për periudhën 2022 – 2024 në kuadër të përgatitjes së buxhetit, ku në fokus të punës së saj është procesi i angazhimit të qytetareve/qytetarëve veçanërisht grave/të rejave duke bashkëpunuar me Administratoret/Administratorët e Njësisë Administrative.
- Zhvillimi i sistemit për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit dhe përdorimi i këtyre të dhënave për përgatitjen e politikave vendore sociale.
- Trajnimi i Komisionit të Barazisë Gjinore pranë Këshillit Bashkiak dhe i stafit të bashkisë me qëllim forcimin e kapaciteteve të tyre për të kuptuar dhe aplikuar Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjnor (BPGJ), përfshirë përdorimin e analizës gjinore në planifikim, buxhetim dhe vlerësim të politikave vendore.

¹ Teksti i Kartës në gjuhën shqipe mund të aksesohet në:

https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

² Për më shumë informacion mbi Këshillin e Bashkive dhe Rajoneve të Evropës, vizitoni:

https://www.ccre.org/en/article/introducing_cemr

³ I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të Projektit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri: "Zbatimi i Kuadrit Ligjor (Acquis) të Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore" (EU4GE), që po zbatohet nga UN Women dhe UNFPA dhe financohet nga Bashkimi Evropian, përmes Fondit të Përshejtit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

FUSHA II: ZVOGËLIMI I STEREOTIPEVE GJINORE, DISKRIMINIMIT DHE DISAVANTAZHIMIT TË SHUMËFISHTË

- Aplikimi i katër programeve të prindërimit pozitiv në katër Qendra Komunitare respektivisht Qendra komunitare Rome, Qendra Komunitare Shushicë, Qendra Komunitare ADRA dhe Qendra komunitare "Një tjetër Jetë", në bashkëpunim me fondacionin A2B.
- Zhvillimi i 30 sesioneve të këshillimit për karrierën, mbi rëndësinë e zgjedhjes së profesioneve qoftë dhe atyre jo tradicionale, në kuadër të zbatimit të projektit "Rrugëtimi i të rejave/rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë", me mbështetjen e Save the Children.
- Koordinimi dhe realizimi i përvitshëm i Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, përmes një kalendari lokal aktiviteteve dhe përfshirjes së aktorëve institucionalë dhe të shoqërisë civile.
- Përmirësimi i aksesit në arsim dhe ofrimi i kushteve më të sigurta e të përgjigjshme gjinore për vajzat dhe djemtë, përmes rikonstruksionit të plotë të 18 objekteve, si shkolla, kopshte, çerdhe nga të cilat 10 në zonat urbane dhe 8 në zonat rurale, për vitin 2024, si dhe rikonstruksionit të pjesshëm të 51 objekteve arsimore, nga të cilat 29 në zonat urbane dhe 22 në zonat rurale, për vitin 2024.

FUSHA III: FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

- Funkcionimi i tregut të përjavshëm për gratë artizane. Është ngritur një treg i vogël i zejeve ku gra/vajza ekzpozojnë dhe shesin punime të ndryshme të realizuara me dorë në mënyrë tradicionale si qilima, veshje popullore, bizhuteri etj. Këto sipërmarrje të vogla janë lehtësuar nga detyrimet për pagesën e tarifave vendore dhe bashkia ka vënë në dispozicion një hapësirë publike.
- Rritja e aksesit të nënave në punësim përmes ofrimit të shërbimeve të kujdesit për fëmijët vajza dhe djem. Është ngritur një shërbim që mundëson kujdesin për fëmijët pasdite deri në orën 18.00, për nënat e vetme që punojnë si edhe për ato në vështirësi ekonomike. Ky shërbim mundësohet nga fondacioni motrat e Nënë Terezës me seli në Elbasan.
- Subvencionimi i tarifave të çerdheve dhe kopshteve për 35 raste të fëmijëve të familjeve në nevojë, kryesisht të familjeve Rome/Egjiptiane, si dhe të rasteve të fëmijëve vajza dhe djem të përfshirë në UM/UMM. Nga ky subvencionim kanë përfituar gjithsej 105 fëmijë në nevojë për periudhën 2022 - 2024.

FUSHA IV: SIGURIA DHE QASJA E KOORDINUAR NË MBROJTJEN NGA DHUNA

- Pajisja e shkollave, kopshteve, çerdheve me kamera për të rritur nivelin e sigurisë së fëmijëve vajza e djem.
- Menaxhimi me efektivitet dhe mbështetja me shërbime bazuar në nevojat përkatëse për vitet 2022 – 2024, e 381 rasteve të reja të dhunës në marrëdhëniet familjare.

- Mbështetja në vazhdimësi e shërbimit të strehimit emergjent, në bashkëpunim me OJF të specializuara që e ofrojnë këtë shërbim, duke mbuluar qeranë e strehëzës.
- Promovimi i Rezolutës 1325 dhe Konventës së Stambollit në bashkëpunim me shkolla, komunitete fetare dhe njësitë administrative.
- Auditime sigurie në 9 çerdhe dhe kopshte publike si pjesë e përpjekjeve për të garantuar sigurinë e fëmijëve dhe stafit.
- Një arritje veçanërisht e rëndësishme gjatë vitit 2024, e pa planifikuar në dokumentin e PVVBGJ, por që ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e masave të parashikuara në objektivin specifik IV.2. "Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore", të këtij plani, ishte ushtrimi i kostimit të shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore (DHF/DHBGJ), i zhvilluar me mbështetjen teknike të UN Women. Ky ushtrim ndihmoi bashkinë të kuptojë më mirë kostot reale të parandalimit, mbrojtjes dhe referimit të rasteve, duke pasur parasysh detyrat dhe përgjegjësitë që ligjërisht mbulon bashkia, si dhe kontribuoi në një planifikim më të informuar të buxhetit të vitit 2025, por edhe të PBA 2025 – 2027, për këto ndërhyrje jetike.

Praktikat e mira përfshijnë bashkëpunimin aktiv të bashkisë me shoqërinë civile në fushatat ndërgjegjëse, përdorimin e platformave në shkolla për edukimin mbi barazinë gjinore si dhe përpjekjet për të integruar çështjet gjinore në planifikimin dhe buxhetimin vendor.

Pavarësisht arritjeve, bashkia në këto vite ka ndeshur edhe vështirësi dhe sfida dhe ka edhe aktivitete të pa realizuara tërësisht ose pjesërisht.

Bazuar në sa më sipër Bashkia Elbasan për vitet në vijim ka përcaktuar si prioritetet:

- Hartimin, miratimin dhe zbatimin e PVVBGJ 2025 – 2030, bazuar edhe në gjetjet dhe rekomandimet nga ky raport monitorimi;
- Institucionalizimin e BPGJ në të gjitha programet buxhetore dhe zgjerimin e pjesëmarrjes në iniciativat për barazinë gjinore;
- Forcimin e mëtejshëm të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe përmirësimin e sistemeve të të dhënave dhe transparencës;
- Përmirësimin e kapaciteteve të stafit për adresimin në mënyrë më efektive të çështjeve të barazisë gjinore në të gjitha fushat e ndërhyrjes së bashkisë, si dhe vënien në dispozicion të burimeve të shtuara financiare, për të siguruar që barazia gjinore të integrohet në mënyrë sistematike në të gjitha politikat dhe shërbimet e bashkisë.

HYRJE

PVVBGJ 2022-2024 i Bashkisë Elbasan është një instrument strategjik, i zhvilluar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030. Ai gjithashtu është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

Vizioni i PVVBGJ 2022 – 2024:

“Gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Elbasanit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantes/migrantit e azilkërkuar/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Fushat kryesore të ndërhyrjes

PVVBGJ 2022 – 2024 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes të paraqitura në vijim:

- I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
- II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.
- III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qendrueshëm.
- IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe efikasitetit të qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Fusha e ndërhyrjes:
I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
Rezultatet e pritshme:
I.a. Përgjegjshmëria dhe transparencja e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.
I.b. Buxheti i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë.
Objektivat specifikë:
I.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.
I.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.
Treguesit në nivel objektiv:
I.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë dhe Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).
I.2.a. Numri i raporteve të monitorimit të buxhetit vjetor të shpenzuar, nga këndvështrimi gjinor, publikuar në faqen e internetit të bashkisë.

I.2.b. Numri i dokumentave të rëndësishëm vendorë të monitoruar nga këndvështrimi gjinor.

Fusha e ndërhyrjes:

II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë

Rezultatet e pritshme:

II.a. Një brez i ri i barazisë i krijuar, që lufton stereotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë.

II.b. Informimi mbi përgjegjësitë prindërore dhe rolin e të dy prindërve në rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre duke luftuar stereotipet gjinore dhe praktikat e dëmshme, i rritur ndjeshëm.

Objektivat specifikë:

II.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.

II.2. Investimi në prindërimin pozitiv.

Treguesit në nivel objektiv:

II.1.a. Numri i personave të përfshirë në aktivitetet edukuese për të luftuar stereotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë.

II.2.a. Numri i prindërve që vlerësojnë dhe marrin pjesë në iniciativat e bashkisë mbi prindërimin pozitiv.

Fusha e ndërhyrjes:

III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm.

Rezultatet e pritshme:

III.a. Veprimet e bashkisë për të krijuar një mjedis punësimi ku harmonizohet jeta personale me atë profesionale, të rritura ndjeshëm.

III.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.

Objektivat specifikë:

III.1. Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive jetën profesionale me atë personale dhe nevojën për përkujdesje për familjarët në varësi.

III.2. Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të rejave, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive.

Treguesit në nivel objektiv:

III.1.a. Numri i personave të pajisur me informacion për luftimin e stereotipeve gjinore në punësim dhe balancimin e jetës profesionale dhe personale.

III.2.a. Numri i grave dhe të rejave sipërmarrëse të mbështetura për përparimin drejt zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

Fusha e ndërhyrjes:

IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Rezultatet e pritshme:

IV.a. Informimi dhe elementët e sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike e private, të rritura ndjeshëm.

IV.b. Mekanizmi i Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe eficient.

Objektivat specifikë:

IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”.

IV.2. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Treguesit në nivel objektiv:

IV.1.a. Numri i misionëve të auditimit të sigurisë të zhvilluara nga stafi i bashkisë në bashkëpunim me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike.

IV.2.a. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

METODOLOGJIA

Ky raport monitorimi është hartuar me qëllim vlerësimin e zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2022–2024 të Bashkisë Elbasan, në përputhje me strukturën dhe objektivat e përcaktuara në dokumentin e miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Procesi i monitorimit është udhëhequr nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe është zhvilluar përmes metodave të mëposhtme:

- Analiza e dokumenteve, përmes shqyrtimit të planeve dhe raporteve vjetore të bashkisë, raporteve të shërbimeve sektoriale, dokumenteve të programimit buxhetor dhe planeve të veprimit sektorialë që lidhen me çështjet gjinore.
- Mbledhja e të dhënave administrative, të siguruara nga strukturat përgjegjëse të bashkisë dhe njësitë administrative përkatëse, përfshirë të dhënat mbi përfitueset/përfituesit e shërbimeve, grupet në fokus, si dhe realizimin buxhetor të aktiviteteve të planifikuara.
- Konsultime dhe intervista me përfaqësues/përfaqësues të grupeve të punës ndërsektoriale, nëpunëse/nëpunës vendorë, organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues/përfaqësues të komunitetit, për të siguruar një vlerësim sa më gjithëpërfshirës dhe realist të ecurisë së zbatimit të planit.
- Përdorimi i mjetit të vetëvlerësimit mbi zbatimin e PVVBGJ, përgatitur me asistencën teknike të UN Women, nëpërmjet të cilit është bërë vlerësimi i progresit për secilën nga fushat e ndërhyrjes dhe objektivat përkatës.

Raporti është strukturuar në përputhje me katër fushat prioritare të planit, duke identifikuar për secilën fushë rezultatet e arritura, sfidat e hasura, si dhe rekomandime për përmirësim.

PËRMBLEDHJE E PROGRESIT TË ZBATIMIT

Bashkia Elbasan ka ndërmarrë një sërë hapash për përparimin drejt barazisë gjinore gjatë zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2022 - 2024. Monitorimi i treguesve kryesorë tregon progres në të katër fushat strategjike të ndërhyrjes:

Fusha I: Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.

Objektivi I.1: Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore

Gjatë periudhës së zbatimit të PPVBGJ, Bashkia Elbasan ka ndërmarrë hapa domethënës për të forcuar kuadrin institucional dhe përgjegjësitë publike për barazinë gjinore. Një ndër arritjet kryesore ka qenë miratimi dhe publikimi i vetë Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) në faqen zyrtare të bashkisë, i shoqëruar me një proces gjithëpërfshirës konsultimi me aktorë vendorë dhe organizata të shoqërisë civile. Ky publikim ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe në sensibilizimin e publikut mbi angazhimet gjinore të bashkisë.

Një tjetër zhvillim pozitiv është funksionalizimi i Komisionit të Barazisë Gjinore (KBGJ) pranë Këshillit Bashkiak, i cili ka mbajtur mbledhje të rregullta dhe ka ndjekur ecurinë e zbatimit të PVVBGJ-së. Gjithashtu, janë përgatitur formatet për mbledhjen e të dhënave të ndjeshme gjinore, si një hap i parë për ndërtimin e një sistemi monitorimi efektiv.

Pjesëmarrja e grupeve të interesit në dëgjuesat publike ka qenë gjithashtu e rëndësishme për përfshirjen e perspektivës gjinore në vendimmarrje.

Për këto arsye, progresi për objektivin I.1 vlerësohet si i përmbushur plotësisht (✓).

Objektivi I.2: Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.

Ky objektivi ka pasur në fokus fuqizimin e kapaciteteve institucionale për të zbatuar Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ) dhe për të integruar perspektivën gjinore në politikat vendore. Gjatë periudhës 2022–2024, janë trajnuar 12 anëtare/anëtarë të Komisionit të Barazisë Gjinore dhe staf teknik i bashkisë mbi konceptet e BPGJ dhe analizën gjinore. Kjo ka ndihmuar në ndërtimin e një baze minimale njohurish, por kërkohet vazhdimësi dhe thellim i këtyre trajnimeve për të ndikuar realisht në proceset buxhetore.

Një analizë buxhetore me fokus gjinor është kryer në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat Gjinore (QDGJ), e cila ka ofruar një pasqyrë fillestare të niveleve të integritetit gjinor në buxhetet ekzistuese. Gjithsesi, ndikimi praktik i analizës në vendimmarrje dhe planifikim mbetet i kufizuar.

Po ashtu, përfshirja e objektivave dhe treguesve gjinorë në tre plane sektoriale tregon për një përpjekje pozitive, por jo ende të institucionalizuar në të gjitha fushat. Dëgjuesat buxhetore me pjesëmarrje aktive të grupeve të grave dhe komuniteteve të tjera kanë ndihmuar në adresimin e nevojave të tyre, megjithëse angazhimi ende mbetet sporadik.

Në këtë kuptim, objektivi I.2 vlerësohet si pjesërisht i realizuar (⚠️) dhe kërkon ndihmë të mëtejshme teknike dhe politike për të përshpejtuar integrimin gjinor në ciklin e plotë të planifikimit dhe buxhetimit vendor.

Objektivi	Tregues Kryesor	Progres
I.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore	PVVBGJ i miratuar dhe publikuar; Komision funksional; Formate për mbledhjen e të dhënave; Pjesëmarrje në dëgjesa	✅
I.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor	12 anwtare/anëtarë të KBGJ dhe staf teknik të trajnuar për BPGJ dhe analizën gjinore; 1 analizë buxhetore me QDGJ; Integrim i këndvështrimit gjinor në 3 plane vendore; Pjesëmarrje aktive në dëgjesa buxhetore	⚠️

Në përgjithësi, progresi është i konsiderueshëm, megjithatë disa aktivitete kërkojnë ndjekje dhe angazhim të mëtejshëm për të përmbushur plotësisht objektivat dhe tejkaluar sfidat që lidhen me kapacitetet e kufizuara teknike për realizimin e analizave të plota gjinore. Lind e nevojshme:

- Fuqizimi i kapaciteteve të stafit për analizën gjinore dhe BPGJ.
- Përmirësimi i sistemit të grumbullimit dhe analizimit të të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore.
- Thellimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për përfshirjen e grupeve të nënpërfaqësuar.

Fusha II: Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.

Gjatë periudhës 2022–2024, Bashkia Elbasan ka shënuar përparime të rëndësishme në zbatimin e objektivave të Fushës II të Planit Vendor për Barazi Gjinore (PVVBGJ), duke synuar transformimin e qëndrimeve shoqërore, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e familjes si njësi bazë e zhvillimit të qëndrueshëm social.

Objektivi II.1: Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore

Në këtë kuadër, janë realizuar mbi 30 aktivitete ndërgjegjëse dhe edukuese në bashkëpunim me OJF-të dhe aktorë të tjerë lokalë, duke përfshirë rreth 4,500 pjesëmarrëse/pjesëmarrës – një arritje që afrohet ndjeshëm me objektivin e vendosur prej 5,000 qytetaresh e qytetarësh. Aktivitetet janë përqendruar në promovimin e modeleve pozitive të grave dhe vajzave në fusha të ndryshme, luftimin e stereotipeve gjinore dhe adresimin e formave të shumëfishta të diskriminimit.

Bashkia Elbasan ka organizuar një sërë eventesh kulturore në zonat rurale si “Festa e Qershive”, “Funar Fest” dhe “Festa e Treganit”, ku gratë dhe vajzat janë promovuar si protagoniste të zhvillimit ekonomik vendor përmes panairove të ushqimit, zejeve dhe produkteve artizanale.

Një komponent kyç i këtij objektivi ka qenë fuqizimi institucional i aktorëve vendorë përmes trajnimeve. Janë realizuar 6 trajnime me pjesëmarrjen e Aleancës së Grave

Këshilltare dhe Komisionit të Barazisë Gjinore pranë Këshillit Bashkiak, duke adresuar tema si: mekanizmat ligjorë për barazinë gjinore, përdorimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ), dhe çështjet e ngacmimit seksual në vendin e punës.

Në aspektin e komunikimit publik, janë shpërndarë rregullisht mesazhe ndërgjegjëse në rrjetet sociale zyrtare në datat simbolike si 8 Marsi, 25 Nëntori dhe 11 Tetori, duke përfshirë përmbajtje në gjuhën rome për të rritur përfshirjen e komuniteteve të marginalizuara. Gjithashtu, janë realizuar me sukses 3 fushata vjetore për “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, në bashkëpunim me aktorë kombëtarë dhe vendorë.

Përfshirja e të rejave dhe të rinjve në këtë objektiv është bërë përmes fuqizimit të Këshillit Vendor Rinor (KVR), një strukturë që nxit lidhësimin, pjesëmarrjen dhe ndërgjegjësimin gjinor në shkolla dhe komunitet. KVR ka zhvilluar projekte konkrete dhe ka kontribuar në mbikëqyrjen qytetare të vendimmarrjes vendore.

Objektivi II.2: Investimi në prindërimin pozitiv

Objektivi II.2 është zbatuar me fokus në krijimin e praktikave të qëndrueshme për prindërimin pozitiv dhe në përfshirjen e rolit të familjes në ndërtimin e një shoqërie të ndjeshme gjinore. Në bashkëpunim me UNFPA, janë trajnuar stafe të qendrave komunitare dhe specialiste/specialistë vendorë mbi konceptet e prindërimit të përgjegjshëm. Më pas, në katër qendra komunitare janë zhvilluar kurse prindërimi, ku morën pjesë 80 prindër (nëna dhe baballarë), krahasuar me objektivin e planifikuar prej 95 prindërish.

Trajnime të veçanta janë zhvilluar edhe me administratoret/administratorët e shkollave në bashkëpunim me Save the Children, me qëllim përfshirjen e shkollës si partner në edukimin për prindërimin pozitiv. Këto ndërhyrje kanë mundësuar krijimin e sinergjive të reja ndërmjet institucioneve arsimore, qendrave komunitare dhe prindërve.

Si rezultat i këtij procesi, janë krijuar dy klube funksionale të prindërimit pranë qendrave komunitare “Shushicë” dhe “Një tjetër Jetë”, të cilat ofrojnë mbështetje psiko-sociale për prindërit dhe nxisin përfshirjen e tyre në aktivitetet komunitare.

Në lidhje me këshillimin paramartesor, përgatitja e një materiali informues mbi të drejtat dhe detyrimet në martesë është në proces zhvillimi si pjesë e projektit “RiseHer”. Megjithatë pilotimi i këshillimit pranë zyrave të gjendjes civile nuk ka nisur ende, ai mbetet një ndërhyrje premtuese për parandalimin e martesave të hershme dhe edukimin ligjor të të rejave/ rinjve.

Tabela e Progresit – Fusha II

Objektivi	Treguesi i Planifikuar	Treguesi i Realizuar	Progresi
II.1 Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore	Të paktën 5,000 pjesëmarrëse/pjesëmarrës në aktivitete ndërgjegjëse dhe edukuese	Rreth 4,500 pjesëmarrëse/pjesëmarrës nga komuniteti në mbi 30 aktivitete	
	Aktivitete kulturore në zonat rurale që promovojnë pjesëmarrjen e grave/vajzave	Organizuar 6 aktivitete tradicionale vjetore me përfshirje të grave në panaire dhe promovim të produkteve	
	6 trajnime për Aleancën e Grave dhe Komisionin e Barazisë Gjinore	Janë realizuar 6 trajnime, me pjesëmarrje të grave këshilltare dhe stafeve sociale	
	3 fushata vjetore ndërgjegjësimi për 16 Ditët e Aktivizmit	3 fushata të realizuara në koordinim me aktorë vendorë dhe kombëtarë	
	Postime të rregullta në rrjete sociale për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës	Postime mujore + për çdo ditë ndërkombëtare përkatëse, edhe në gjuhën rome	
II.2 Investimi në prindërimin pozitiv	95 prindër të përfshirë në programet e prindërimit pozitiv në qendrat komunitare	80 prindër të përfshirë në 4 qendra komunitare	
	Të paktën 2 trajnime për administratoret/administratorët e shkollave mbi prindërimin pozitiv	2 trajnime të realizuara në bashkëpunim me Save the Children	
	Të paktën 2 klube të prindërimit të ngritura	2 klube të ngritura në Shushicë dhe “Një tjetër Jetë”	
	Hartimi dhe shpërndarja e materialit informues për këshillimin paramartesor	Materiali është në proces hartimi në kuadër të projektit “RiseHer”	
	Pilotimi i këshillimit paramartesor në zyrat e gjendjes civile	Nuk ka nisur ende	

Aktivitetet e realizuara kanë kontribuar në:

- Rritjen e kapaciteteve të stafit komunitar dhe institucional për të adresuar çështje të prindërimit dhe barazisë gjinore;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe prindërve mbi rëndësinë e prindërimit pozitiv;
- Krijimin e sinergjive ndërmjet shkollave, qendrave komunitare dhe organizatave joqeveritare për të mbështetur familjet;
- Hedhjen e hapave për institucionalizimin e këshillimit paramartesor në nivel vendor.

Zbatimi i plotë i të gjithë aktiviteteve të këtij objekti do të përforcojë më tej angazhimin e Bashkisë Elbasan për të ndërtuar një shoqëri ku familjet funksionojnë mbi baza të barazisë, respektit dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor.

Fusha III: Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qendrueshëm.

Gjatë periudhës së zbatimit të PVVBGJ 2022–2024, Bashkia Elbasan ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për promovimin e barazisë gjinore në fushën e punësimit dhe zhvillimit ekonomik.

U realizuan fushata të gjera ndërgjegjëse dhe informuese që arritën mbi 20,000 individë – duke tejkaluar targetin e vendosur në plan. Këto aktivitete kanë përfshirë informim me komunitetin, punëdhënëse/punëdhënëse, punëkërkuese/punëkërkues, gra të përfshira në bujqësi dhe biznese, si dhe nxënëse/nxënëse e të reja/rinj për promovimin e profesioneve jo tradicionale për vajzat. U organizuan gjithashtu takime me gra në fasoneri për të sfiduar stereotipet gjinore dhe për të informuar mbi të drejtat në vendin e punës.

Në kuadër të nxitjes së sipërmarrjes dhe punësimit të grave, u krijua një treg artizanal për gra sipërmarrëse, u ofrua kujdes për fëmijët vajza dhe djem në “Shtëpia e Gjyshes”, dhe u zhvilluan trajnime në bujqësi për 25-30 gra në NJA Labinot-Mal. Megjithatë, përqindja e grave të mbështetura në sipërmarrje mbeti vetëm 0.03%, shumë larg targetit prej 1%, çka tregon nevojën për ndërhyrje më të forta. U evidentua gjithashtu mungesë e të dhënave të detajuara të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore, si dhe progres i pjesshëm në nisma si aftësimi digjital apo brandimi i produkteve.

Tabela Përmbledhëse – Fusha III

Objektivi	Tregues të Planifikuar	Tregues të Realizuar	Vlerësimi i Progresit
III.1: Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të promovuar ekuilibrin jetë/punë	- Informimi i 18,000 personave mbi barazinë gjinore në punësim dhe balancimin jetë/punë	- Mbi 20,000 persona të informuar përmes aktiviteteve sensibilizuese me punëkërkuues/e, komunitetin, fasoneri, prindër dhe të rinj/reja	 I tejkaluar
III.2: Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të rejave, rritja e aksesit në shërbime dhe burime	- Mbështetja e 1% të grave/vajzave për të nisur ose forcuar sipërmarrje - Aktivitetet për rritjen e aksesit në panairë, trajnime digjitale dhe certifikim pronësie	- Vetëm 0.03% e mbështetura - Treg artizanal i zhvilluar - 345 certifikata pronësie të shpërndara (55 për gra) - Trajnime për 25–30 gra - Hapja e “Shtëpisë së Gjyshes” - Trajnime për gratë për dalje nga ndihma ekonomike	 Pjesërisht i realizuar

Aktivitetet e zhvilluara kanë ndihmuar në:

- Rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e zgjedhjes së profesioneve jo tradicionale dhe pjesëmarrjes së vajzave në STEM;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në promovimin e punësimit për grupet në nevojë dhe të rejt/rinjtë me potencial inovativ;
- Nxitjen e diskutimeve për ndarjen e barabartë të punës dhe kujdesit në familje si pjesë e një kulture të barazisë gjinore.

Nga ana tjetër aktivitetet e realizuara në kuadër të këtij kapitulli kanë ndikuar në:

- Lehtësimin e punësimit të grave përmes mbështetjes për kujdesin ndaj fëmijëve;
- Nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave dhe promovimin e trashëgimisë kulturore përmes zejeve tradicionale;
- Mbështetjen e grave në bujqësi dhe përpjekjet për t'i larguar nga varësia ndaj ndihmës ekonomike;
- Rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat pronësore të grave në komunitet.

Fusha IV: Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Objektivi IV.1: Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”.

Zbatimi i objektivit IV.1 ka shënuar progres të lartë dhe ka tejkaluar treguesit e planifikuar. Janë realizuar 14 auditime sigurie nga stafi bashkiak në bashkëpunim me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike (KVSP), duke dyfishuar objektivin e planifikuar prej 6 auditimesh. Në total janë zhvilluar 40 misione auditimi në lagje dhe Njësi Administrative, duke identifikuar problematikat dhe orientuar vendimmarrjen për ndërhyrje infrastrukturore.

Janë zhvilluar 10 ditë të hapura për sigurinë me pjesëmarrjen e institucioneve kryesore vendore, përfshirë Bashkinë, Policinë dhe Prokurorinë, ku janë trajtuar çështje të sigurisë publike, ekstremizmit dhe dhunës me bazë gjinore. Janë përfshirë gra dhe vajza si kontribuuese aktive në identifikimin e problematikave dhe propozimin e ndërhyrjeve konkrete, përfshirë ndriçimin publik dhe instalimin e kamerave në shkolla, rrugë dhe kopshte.

Për promovimin e Rezolutës 1325 janë organizuar takime në NJA, gjimnaze dhe universitete, si dhe takime mbi Konventën e Stambollit. Në fokus kanë qenë rolet gjinore, adresimi i dhunës në familje dhe përfshirja e komuniteteve fetare në parandalimin e radikalizmit. Gjithashtu, janë zhvilluar 30 takime ndërgjegjëse me nxënës/nxënës mbi ekstremizmin e dhunshëm.

KVSP është konsoliduar si një mekanizëm funksional dhe i bashkërenduar për sigurinë publike dhe ka përfshirë takime të dedikuara për koordinimin ndërsektorial. Përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të komunitetit, zbatimi i objektivit ka arritur rezultate konkrete dhe të matshme, duke e shndërruar Bashkinë e Elbasanit në një praktikë të mirë bashkëpunimi institucional. Zbatimi i këtij programi ka treguar përkushtimin e Bashkisë Elbasan për të krijuar një mjedis më të sigurt për të gjithë qytetaret/qytetarët, me theks të veçantë tek grupet në nevojë dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore. Mekanizmat si KVSP dhe ndërhyrjet ndërsektoriale kanë forcuar kapacitetet institucionale për menaxhimin e sfidave të sigurisë.

Rekomandime:

- Rritja e pjesëmarrjes së të rejave/rinjve në proceset vendimmarrëse vendore për siguri.
- Integrimi më i gjerë i perspektivës gjinore në politikat e urbanistikës dhe infrastrukturës.
- Thellimi i bashkëpunimit me institucionet arsimore për edukimin e hershëm mbi sigurinë dhe barazinë gjinore.

Objektivi IV.2: Fuqizimi dhe rritja e eficensës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Bashkia Elbasan ka zbatuar me përkushtim objektivin IV.2, duke përforduar funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit. Është organizuar një trajnim dy-ditor për MKR, koordinatoren e dhunës në familje dhe stafin e njësive administrative, me fokus zbatimin e protokolleve ligjore dhe menaxhimin e rasteve të dhunës.

MKR është mbledhur në mënyrë periodike dhe ka bashkëpunuar ngushtë me strukturat e tjera vendore për menaxhimin efektiv të rasteve të dhunës. Aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetin kanë ndihmuar në identifikimin e hershëm të rasteve dhe në referimin e duhur të tyre, duke e bërë ndërhyrjen më të koordinuar dhe të qëndrueshme.

Janë zhvilluar gjithashtu takime me administratën vendore, Këshillin Bashkiak dhe organizatat e shoqërisë civile, për të rritur ndërgjegjësimin mbi dhunën në familje dhe rolin e MKR për parandalimin dhe trajtimin e rasteve. Bashkia Elbasan ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetet për mbrojtjen e viktimave dhe për zbatimin e përgjegjësiave të përcaktuara në kuadrin ligjor.

Një arritje veçanërisht e rëndësishme gjatë vitit 2024, e pa planifikuar në dokumentin e PVVBGJ, por që ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e masave të parashikuara në objektivin specifik IV.2. “Fuqizimi dhe rritja e eficensës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore”, të këtij plani, ishte ushtrimi i kostimit të shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore (DHF/DHBGJ), i zhvilluar me mbështetjen teknike të UN Women. Ky ushtrim ndihmoi bashkinë të kuptojë më mirë kostot reale të parandalimit, mbrojtjes dhe referimit të rasteve, duke pasur parasysh detyrat dhe përgjegjësitë që ligjërisht mbulon bashkia, si dhe kontribuoi në një planifikim më të informuar të buxhetit të vitit 2025, por edhe të PBA 2025 – 2027, për këto ndërhyrje jetike.

Zbatimi i këtij objektivi ka sjellë ndikime të prekshme në nivel vendor:

- **Rritje e efikasitetit dhe profesionalizmit institucional** në trajtimin e dhunës në familje, falë trajnimeve dhe bashkëpunimit ndërsektorial.
- **Mbështetje e drejtpërdrejtë për viktimat/të mbijetuarat**, përmes shërbimeve të strehimit emergjent dhe afatgjatë, si dhe kujdesit falas për fëmijët.
- **Funksionalizim i mekanizmave vendorë të referimit dhe ndjekjes**, përfshirë përmirësimin e dokumentimit dhe ndarjen e informacionit.
- **Përfshirje më e mirë dhe me ndjeshmëri gjinore e sociale** në institucionet e kujdesit parashkollor, përmes trajnimit të edukatoreve dhe politikave të mbrojtjes së fëmijëve.

- **Konsolidim i sistemit të shërbimeve sociale** përmes ngritjes së strukturës së monitorimit dhe rritjes së transparencës.

Tabela e Objektivave IV.1 dhe IV.2

Objektivi	Tregues të Planifikuar	Tregues të Realizuar	Vlerësimi i Progresit
IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe rritja e informimit për Rezolutën 1325	- 6 auditime sigurie - 10 ditë të hapura për sigurinë - Takime me komunitetin për ndjesinë e sigurisë - Takime për promovimin e Rezolutës 1325 - Trajnim për stafin dhe koordinatoren për dhunën - Përfshirja e KVSP dhe MKR në trajtimin e rasteve - Aktivitet informues për radikalizmin dhe ekstremizmin	- 14 auditime sigurie - 10 ditë të hapura me pjesëmarrje të policisë, prokurorisë, komunitetit - Takime komunitare në lagje dhe NJA për sigurinë - Takime, leksione dhe diskutime mbi Rezolutën 1325 dhe Konventën e Stambollit - Trajnim 2-ditor me stafin vendor dhe koordinatoren - 2 takime të përbashkëta MKR–KVSP–ETN - 30 takime ndërgjegjësuere mbi radikalizmin me të rejtat/rinjtë	 Progres i plotë dhe tejkalim objektivash
IV.2. Fuqizimi dhe rritja e eficensës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR)	- Trajnim për MKR dhe stafin e njësive - Mbledhje periodike të MKR - Takime me komunitetin për ndërgjegjësim - Koordinim me institucionet vendore për rastet e dhunës	- Trajnim 2-ditor për MKR dhe stafin - MKR funksional dhe me mbledhje të rregullta - Takime me komunitetin, Këshillin Bashkiak, OJF - Veprime të koordinuara me policinë, prokurorinë, OJF, e	 Ka nevojë për përmirësim

Përqindja e buxhetit bashkiak të dedikuar për shërbime të specializuara për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje dhe me bazë gjinore arriti në 0.9% në vitin 2024, duke shënuar progres drejt objektivit 2%, por duke treguar ende nevojë për priorizim më të madh buxhetor.

Tabela : Përmbledhje e Objektivave të PVVBGJ dhe Progresit të Treguesve – Bashkia Elbasan, 2024

Fusha Ndërhyrëse	Objektivi Specifik	Treguesi	Objektiv i 2024	Rezultat i 2024	Progresi
I. Qeverisja për barazinë gjinore	I.1. Forcimi i llogaridhënies dhe transparencës	Nr. i raporteve monitoruese të LGAP-it të publikuara	1	1	✅ Arritur
	I.2. Zbatimi i BPGJ dhe integrimi i barazisë gjinore	Nr. i raporteve monitoruese të BPGJ të publikuara	1	1	✅ Arritur
		Nr. i dokumenteve lokale të monitoruara nga perspektiva gjinore	1	2	✅ Tejkualuar
II. Reduktimi i stereotipeve dhe diskriminimit	II.1. Promovimi i edukimit për barazinë gjinore	Nr. i individëve të përfshirë në aktivitetet ndërgjegjësues	5,000	4,500	⚠️ Pak më poshtë objektivit
	II.2. Investimi në prindërimin pozitiv	Nr. i prindërve të përfshirë në aktivitetet për prindërimin pozitiv	95	80	⚠️ Pak më poshtë objektivit
III. Fuqizimi ekonomik i grave	III.1. Sfidat ndaj stereotipeve gjinore në punësim dhe mbështetja e ekuilibrit punë-jetë	Nr. i individëve të informuar mbi barazinë gjinore në punësim	18,000	20,000	✅ Tejkualuar
	III.2. Mbështetja e grave dhe vajzave në sipërmarrje	% e grave/vajzave të mbështetura në sipërmarrje	1%	0.03%	⚠️ Ka nevojë për përmirësim ; Shumë më poshtë objektivit

IV. Siguria dhe mekanizmat e referimit	IV.1. Përmirësimi i sigurisë publike dhe ndërgjegjësimi mbi Rezolutën 1325	Nr. i auditimeve të sigurisë të kryera me Këshillin Vendor të Sigurisë	6	14	 Tejkualuar
	IV.2. Forcimi i shërbimeve të referimit për rastet e dhunës	% e buxhetit vendor të dedikuar për DV/GBV	2%	0.9%	 Ka nevojë për përmirësim

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR DHE ALOKIMET

Bashkia Elbasan ka vijuar përpjekjet për institucionalizimin e BPGJ në ciklin e politikave vendore, në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat vendore” dhe Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2022–2024.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë disa veprime konkrete:

- U realizua një analizë buxhetore me lente gjinore, që përfshiu prioritetet gjinore në programet e mbrojtjes sociale.
- U zhvillua një trajnim mbi BPGJ dhe analizën gjinore, ku morën pjesë anëtarë të Komisionit të Barazisë Gjinore dhe stafi teknik i bashkisë, duke rritur kapacitetet për integrimin gjinor në procesin buxhetor.
- U organizuan dëgjesa publike me pjesëmarrje të grave dhe grupeve të marginalizuara, duke siguruar reflektimin e nevojave të tyre në prioritetet vendore.
- Sa i përket alokimeve financiare, pjesa e buxhetit vendor e dedikuar për shërbime të specializuara për viktimat e dhunës me bazë gjinore arriti në 0.9%, që përbën një përparim krahasuar me vitin e kaluar, por ende mbetet nën objektivin prej 2% të përcaktuar në PVVBGJ.

Pavarësisht progresit, BPGJ mbetet një proces në zhvillim, që kërkon:

- Identifikim të qartë të objektivave gjinore në të gjitha programet buxhetore,
- Përmirësim të sistemeve të të dhënave të ndara sipas gjinisë,
- Mbështetje teknike dhe angazhim të qëndrueshëm institucional për të përfshirë perspektivën gjinore në ciklin e buxhetit.

Në lidhje me zbatimin e PVVBGJ 2022 – 2024, bashkia Elbasan kishte planifikuar të alokonte dhe të shpenzonte nga fiondet e veta 27,041,158 lekë, të cilat përfshinin edhe kontribute nga natyrë (salla, mjete, etj) si edhe paga të stafit ekzistues për kohën që do të dedikonin zbatimit të PVVBGJ 2022 – 2024.

Nga monitorimi i zbatimit të PVVBGJ 2022 – 2024 rezulton se në lidhje me burimet e nevojshme financiare, Bashkia Elbasan ka alokuar dhe shpenzuar gjithsej 24,285,359 lekë, ose 90% të kostos së planifikuar. Alokimet dhe shpenzimet më të ulëta kanë qenë në lidhje me zbatimin e fushës II “Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumfshistë”. Kjo pasi në zbatimin e kësaj fushë Bashkia ka bashkëpunuar ngushtësisht me organizatat e shoqërisë civile dhe donorët dhe ka mundur zhvillimin e një sërë aktiviteteve të planifikuara përmes burimeve të tjera të dedikuara nga këta partnerë.

SFIDAT NË ZBATIM

Edhe pse zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2022 – 2024 në Bashkinë Elbasan ka treguar përparim, disa sfida institucionale, financiare dhe shoqërore kanë penguar arritjen e plotë të objektivave të planifikuara.

Një nga sfidat kryesore institucionale ka qenë mungesa e koordinimit sistematik midis drejtorive në lidhje me çështjet e barazisë gjinore. Kjo ka sjellë vonesa në zbatimin e aktiviteteve ndërsektoriale, veçanërisht atyre që kërkojnë bashkëpunim midis sektorëve të shërbimeve sociale, arsimit, shëndetësisë dhe financave. Nëpunësja për Barazinë Gjinore (NBGJ), operon me mbështetje të kufizuar administrative, gjë që e kufizon aftësinë e saj për të mbikëqyrur zbatimin e PVVBGJ dhe për të integruar në mënyrë efektive çështjet gjinore në të gjitha politikatat.

Kufizimet financiare kanë paraqitur gjithashtu pengesa. Megjithëse disa fonde bashkiake janë alokuar për aktivitete të përgjigjshme gjinore, shuma e përgjigjshme mbetet e pamjaftueshme. Në vitin 2024, vetëm 0.9% e buxhetit vendor është dedikuar për shërbimet e specializuara për dhunën në familje dhe me bazë gjinore (DHF/DHBGJ) ndjeshëm më poshtë objektivit të PVVBGJ prej 2%. Për më tepër, shumë drejtori nuk kanë një linjë të dedikuar buxhetore për aktivitetet e PVVBGJ, duke u mbështetur kryesisht në iniciativa të bazuara në projekte ose fonde donatorësh, gjë që e kufizon qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë.

Mungesa e të dhënave gjithëpërfshirëse të ndara sipas seksit, si dhe e statistikave gjinore, në të gjitha sektorët vendorë e bën të vështirë vlerësimin e ndikimit të politikave dhe shërbimeve.

Ekziston një njohuri e kufizuar institucionale për statistikatat gjinore, mjetet e buxhetimit gjinor dhe metodologjitë e analizës gjinore.

Së fundmi, pengesat shoqërore dhe kulturore vazhdojnë të ndikojnë në efektivitetin e disa iniciativave. Steriotipet gjinore vazhdojnë të jenë të pranishme në disa komunitete, duke ndikuar në pjesëmarrjen si të grave, ashtu edhe të burrave në programe si prindërimi pozitiv dhe mbështetja për sipërmarrjen. Për më tepër, përfshirja e burrave dhe djemve në mënyrë domethënëse në fushatat ndërgjegjësuëse dhe dialogët mbi barazinë gjinore mbetet një sfidë, e cila nga ana tjetër ndikon në transformimin më të gjerë të perceptimeve dhe sjelljeve.

PRAKTIKAT E MIRA DHE HISTORITË E SUKSESIT

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2022 - 2024 në Bashkinë Elbasan, sidomos për vitin 2024, u karakterizua jo vetëm nga progresi ndaj treguesve kryesorë, por edhe nga shfaqja e disa praktikave dhe përvojave që ofrojnë mësim të vlefshme për t'u replikuar dhe shkallëzuar në të ardhmen.

Elbasani demonstroi një angazhim të fortë të komunitetit në aktivitetet ndërgjegjëse. Më shumë se 4,500 individë morën pjesë në nisma edukative të drejtuara për të luftuar stereotipet e dëmshme gjinore dhe diskriminimin. Këto fushata u zbatuan në bashkëpunim me organizatat vendore të shoqërisë civile, grupet e të rejave/rinjve dhe institucionet arsimore, duke ndihmuar në zgjerimin e ndikimit dhe gjithëpërfshirjen. Veçanërisht, disa nga këto aktivitete përfshinë strukturat shkollore dhe njësitë e lagjeve, duke nxitur një dialog të lokalizuar dhe të ndjeshëm ndaj kontekstit për barazinë gjinore. Një tjetër histori suksesi që po merr formë është bashkëpunimi efektiv për auditimet e sigurisë në hapësirat publike. Këto vlerësime identifikuan shqetësime kryesore për sigurinë dhe informuan përmirësime në infrastrukturën publike, si ndriçimi, sinjalistika dhe krijimi i hapësirave të sigurta, veçanërisht pranë shkollave dhe qendrave komunitare.

Për më tepër, edhe pse në shkallë ende të kufizuar, rritja e numrit të prindërve, sidomos baballarëve, që marrin pjesë në seanca për prindërimin pozitiv përfaqëson një ndryshim kulturor në rolet gjinore brenda familjes. Mbështetja e bashkisë për këto programe, edhe me burime të kufizuara, dëshmon për njohjen e kujdesit familjar dhe mirëqenies si pjesë të rëndësishme të barazisë gjinore.

Këto përvoja tregojnë se, me mbështetje të synuar, bashkëpunim ndërsektorial dhe vullnet të vazhdueshëm politik, qeveritë vendore mund të gjenerojnë rezultate të prekshme dhe me ndikim në fushën e barazisë gjinore. Ato gjithashtu theksojnë rëndësinë e dokumentimit dhe ndarjes së këtyre praktikave për të nxitur mësimin ndërmjet bashkive dhe ndryshimin institucional më të gjerë.

REKOMANDIME DHE HAPAT NË VIJIM

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme të nxjerra nga monitorimi i zbatimit të PVVBGJ 2022 – 2024, për vitet në vijim Bashkia Elbasan ka formuluar këto rekomandime, që duhet të kopsniderohen dhe të përfshihen nga grupi i punës që po harton PVVBGJ 2025 – 2030:

- *Forcimi i koordinimit të mekanizmave të llogaridhënies:* Zbatimi i suksesshëm i angazhimeve për barazinë gjinore kërkon bashkëpunim të strukturuar midis drejtorive të bashkisë. Krijimi i një grupi koordinues të dedikuar për monitorimin e zbatimit të PVVBGJ, me mandat të qartë dhe takime të rregullta, do të përmirësonte koordinimin dhe do të siguronte ndarjen e përgjegjësisë për arritjen e objektivave.
- *Sigurimi i alokimeve të dedikuara dhe të qëndrueshme buxhetore për prioritetet e PVVBGJ:* Për të arritur objektivat e parashikuara, bashkia duhet të punojë për të institucionalizuar një linjë të dedikuar buxhetore të përgjigjshme gjinore në të gjitha programet përkatëse. Kostimi i aktiviteteve të PVVBGJ duhet të kryhet në mënyrë të rregullt dhe të lidhet me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).
- *Përmirësimi i disponueshmërisë dhe përdorimit të të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore:* Një plan përmirësimi të të dhënave duhet të hartohet në bashkëpunim me drejtoritë dhe institucionet vendore. Kjo përfshin integrimin e treguesve gjinorë në sistemet e monitorimit të programeve dhe sigurimin që raportet e BPGJ-së dhe PVVBGJ-së të bazohen në evidenca të plota.
- *Institucionalizimi i trajnimeve dhe ndërtimi i kapaciteteve për barazinë gjinore dhe BPGJ:* Stafi vendor, përfshirë financieret/financierët, punonjëset/punonjësit e shërbimeve sociale dhe drejtueset/drejtuesit e drejtorive, kanë nevojë për programe të strukturuar trajnimi mbi statistikat gjinore, planifikimin, buxhetimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndjeshme gjinore.
- *Zgjerimi i shtrirjes dhe përfshirjes së grupeve të nënpërfaqësuar:* Duhet të bëhen përpjekje për të përfshirë më shumë burrat dhe djemtë, komunitetet rome dhe egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera vulnerabël në iniciativat e PVVBGJ. Fushata të dedikuara dhe formate të aksesueshme komunikimi mund të ndihmojnë në rritjen e pjesëmarrjes.
- *Rritja e transparencës përmes publikimit dhe ndarjes së raporteve dhe rezultateve:* Bashkia duhet të sigurojë që të gjitha raportet e monitorimit, përfshirë analizat e BPGJ-së dhe përmbledhjet e progresit të aktiviteteve, të publikohen në faqen zyrtare të internetit. Kjo jo vetëm që rrit llogaridhënien, por edhe mundëson shkëmbimin e praktikave të mira dhe njohjen nga bashki të tjera dhe aktorë kombëtarë.